REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-2287/26 datë: 17.06.2026

Npi – 01/145 datë: 26.06.2026

Duke u bazuar në nenin 12.2 shkronja (d) dhe nenin 40.2 shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Nenin 60 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048; Si dhe bazuar në Qarkoren Buxhetore 2027/01 e lëshuar nga Ministria e Financave me datën 15.05.2026, me numër protokolli Nr.987/2026; Pas diskutimit publik me qytetarë, dhe me grupe të interesit, Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e mbajtur më: 26.06.2026, miratoi:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE TË KOMUNËS SË SHTIMES PËR PERIUDHËN 2027-2029 (pas diskutimit publik).

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e -V- të rregullt për vitin 2026, të mbajtur më: 26.06.2026, me shumicën e votave miratoi, Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Shtimes për periudhën 2027-2029 (pas diskutimit publik).

II

Kuvendi i Komunës mori parasysh Diskutimet Publike me qytetarë dhe lagje urbane të Shtimes, Procesverbalet me numër protokoli nga Nr.02/780 deri 02/782.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Zyrës për Financa, Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, Ministrisë për Financa dhe Zyrës për Informim.

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SHTIMES-OPŠTINA ŠTIMLJE
SHTIME-ŠTIMLJE

Kryesuesi i Kuvendit
Rrahman Jakupi